



"për një Shqipëri më të mirë"

"për bashkimin e vërtetë të kombit"

"për mbarëvajtjen e atdheut"



Enver Hoxha u sulmua dhe po sulmohet pamëshirë nga qarqet reaksionare, por këto sulme kurrë s'do t'ia humbin vlerat e tij revolucionare!

...Se goditet ari prej gurit, mos u çudit aspak,
vlerë e gurit nuk iu shtua as e arit nuk iu mpak!
(Poezi persiane)

Ne, revolucioanarët nuk po habitemi aspak pse përsëri po sulmohet i madhi atdhetar, komandanti i LANÇ, shoku Enver Hoxha.

Ne, kemi parë dhe lexuar se komandanti ynë legjendar dhe shokët e shoqet e tij, nuk e kishin rrugën të shtruar me lule, që nga koha e vështirë e luftës së dytë botërore, kësaj lufte frontale me fashistët e nazistët italo-gjermanë.

Shkruan: Fadil SHYTI
Suedi, 25 tetor 2008

Fashistët e zinj e ndoqën ta burgosin Enverin legjendar, i shkuan në shitoren "Flora", aty ku punonte, por Ay, me zgjuarsinë dhe trimërinë që e karakterizonte ua hodhi: kur karabinierët e pyetën a gjendet Enveri këtu; djaloshi guximtar pa iu trembur syri me gjakftohtësi iu tha: - po, këtu është dhe filloi të thërras me zë: "Enver, Enver, Enver, njëkohësisht doli nga dera prapa shitores që e shpiente drejt kopshtijeve; fashistët e egër dhe të marrë, duke menduar se do t'ju vinte Enveri, e prisnin kot, mirëpo, Enveri, udhëheqësi i demonstruesve të demonstratës së 28 Nëntorit 1941, i kaloi kopshtijet dhe muret e shtëpive tiranase dhe i hyri ilegalitetit, duke zhvilluar luftën çlirimtare nga një udhëheqës i grupeve komuniste guerile ilegale në qytete, për t'iu qepur maleve duke u prirë çetave, batalioneve, brigadave, dhe divizioneve partizane.

Pra, siç shkruan në kujtimet e tij: "fashistëve, ua lash vetëm emrin tim në bllokun e tyre"!

Pas fitores mbi fashizmin dhe mbi bashkëpunëtorët e tij, duke filluar nga zogistët, të cilët gjatë luftës kishin ikur nga sytë këmbët me në krye të parin e tyre; satrapin Ahmet Zogu, i cili për 18 vjet gjatë regjimit të tij "të hurit e të litarit" - siç e quante i madhi, Enver Hoxha; pasi i burgosi, Ali Kelmendin, Qemail Stafën e shumë të tjerë, pasi i vrau shumë atdhetarë opozitarë si: Hasan Prishtinën, Bjaram Currin, Avni Rustemin, e syrgjynosi dhe e vrau në Itali poetin famëmadh, Luigj Gurakuqin, e syrgjynosi Fan Stelian Nolin, dhe shumë atdhetarë të tjerë; bëri koncesione të mëdha me fqinjët grabitçarë e në veçanti me Serbinë dhe Italinë, Pra, e qiti Shqipërinë në ankandë tek të huajt, për ë ardhur në pushtet ia dha Serbisë, Shën Naumin dhe Vermoshin; dhe së fundi e përmbylli misionin e tij "mbretëror" kundër-Shqipëri derisa fashistëve të Musolinit ua la vendin në duar të "sigurta" gjakatave për ta "modernizuar" dhe "evropianizuar" me alla romano, duke sjelle me zjarr e barot kulturën europiane dhe tok me suitën e tij, e grabiti arin e popullit dhe iku për të jetuar në luksin e paparë nëpër botë, me arin e plaçkitur të popullit shqiptar. Po të kësaj linje të egër tradhtarë ishin edhe sivëllezërit e tij "atdhetarë", si: "ballistët", "legalistët"

dhe “zjarristet”, të cilët me të gjitha format dhe mjetet ishin vënë në shërbime të armiqve fashistë.

Po kush i doli zot vendit të shqipeve?

Askush tjetër si biri i madh i kombit, Enver Hoxha me shokët dhe shoqet e tij besnikë të popullit dhe të atdheut.

Për Enver Hoxhën dhe komunitet, të organizuar në PKSH-së, pas luftës kjo do të quhej PPSH-së, do të fillonte lufta e re në dy fronte kryesore: lufta për ndërtimin e atdheut nga të gjitha fushat e jetës dhe mbrojtja nga armiqtë e jashtëm e të brendshëm, -që ishin të përbetuar kundër pushtetit popullor i dalur nga gryka e pushkës.

Duke filluar nga zhdukja e analfabetizmit e deri tek ndërtimi i hidrocentraleve, kjo qe rrugëdrita e përpjekjeve për zhvillimin e Shqipërisë nga Gjeniu Enver Hoxha dhe PPSH-së.

Gjatë kësaj periudhe të ndritur historike asnjëherë nuk u harruan problemet e mëdha që popullit ia kishin bërë jetën ferr; zhdukja vëllavrasjes, lufta kundër paditurisë si: zakonet e prapabetura; fejesat në djep, ndalimi i vajzave nga shkollat, ndalimi i grave nga puna, sundimi i dhunshëm në familje nga ana e burrit ose gruas, zhdukja e ligjeve të egra të kanunit të maleve, i cili e himnizonte vëllavrasjen dhe shtypjen e egër ndaj femrës shqiptare.

Në epokën e ndritur të Enver Hoxhës, u ruajtën me xhelozinë më të madhe traditat tona të lavdishme si: nderi, besa, humanizmi, flamuri etj etj...

Në epokën e ndritur të Enver Hoxhës, pamëshirë u luftuan të kobezezat, që sot e kanë mbërthyer botën kapitaliste si: droga, e cila duke hapur tragjedi të reja, madje po kultivohet dhe në tokën shqiptare - krim mbi vetveten apo jo?! Sot, Shqipëria rënkon nga kjo “mortajë bardhë”, nga e cila matrapazët dhe gjakpirësit e popullit, vet po pasurohen, ndërsa shoqërisë shqiptare e në veçanti rinisë po ia prejnë si me thika të lirive “demo(n) kratike” ardhmërinë...

Sot, Shqipëria po rënkon nga korrupsioni, i cila i ka hapur kthetrat dhe i ka mbuluar “kupolat” e pushtetit të sotëm në Shqipërinë administative...

Këta matrapazë politikë, me në krye Sali Berishën, duke u lidhur me njëmijë e një fije me qarqet më reaksionare në Ballkan dhe më tej, janë zhytur si mos më keq në afëra të pista duke filuar nga vitet ‘90-ta, në tregtinë me naftë me shtetin më armik të kombit shqiptar, me Serbinë, janë zhytur gjithashtu në aferën e madhe ekonomike, si ajo e piramidave “berishjane”, e cila e solli Shqipërinë deri në prag të një lufte vëllavrasëse në vitin tonë fatzi më 1997 e deri tani, kur afëra e armëve me Delijorgjin, e cila e përgjaku Gëdecin për të vijuar turpin e zi deri tek afëra “Fazlliq”, që po e neveritë botën...

Shqipëria e sotme nuk qëndron krenare, siç ishte krenare në vitet e “diktaturës” nga turpet e kohës e mbështjellë si me veladan të zi, nga “eksport-importi” më i shëmtuar njerëzor dhe kombëtar, siç është prostitucioni, i cili i ka kaluar dhe kufijt drejt Ballkanit

dhe Europës. Kjo, padyshim, sot dhe nesër e vret dhe do ta vret ndërgjegjen tonë kombëtare.

Pra, në ato vite të “diktaturës” kombi shqiptar, ishte me ndërgjegje dhe trup të pastër, kishte shëndetin dhe gjallërinë shpirtërore optimiste, sepse, moralin kombëtar e kishte të pastër.

Kujtoj këtu idenë e madhe gjeniale të E.Heminguejit, i cili thoshte: “mos pyet për kë bie këmbana, ajo bie për ty”!... Tragjedi të tilla na kanë ngjarë ne shqiptarëve dhe gjatë luftës, kur aq shumë femra shqiptare nga dhuna mizore kanë rënë viktimë të çetnikëve serbë. Por, kjo atyre motrave tona shqiptare, aspak nuk duhet t’ju shkojë mendja se viktimizimi me dhunë ua ka ulur vlerat e tyre morale; vlerat morale ulen vetëm tek ato femrat “shqiptare”, të cilat të harlisuara dhe të mashtruara pas përfitimeve “të mëdha” e shkelin moralin e tyre, pa e kuptuar se në ç’batake të pista kanë rënë!

Shqipëria, sot po rënkon nga korrupsioni, madje (sikur në antikë) po bëhet tregtia me pjesë të gjymtyrëve të trupit të foshnajve e të njerëzve, të rënë viktimë të kësaj mafie të egër; këto prapësi gjakatare, në ato vite të “diktaturës” as nuk mund të ëndrroheshin nga shqiptarët, kurse tani hapja “pa kufi” me botën e “lirive dhe të drejtave të njeriut” edhe Shqipëria e sotme “kapitaliste” alias feudaliste, ka rënë në këto kurthe e komplete të egra të brendshme e të jashtme.

- Po e përkujtoj këtu një ide të madhe të një punëtori atdhetar, i cili quhet, Idriz Pasha, ai me një rast, kur i pa të shkatërruara dhjetëra fabrika, të cilat ishin kthyer në gërmadha nga regjimi “demokratik”, i revoltuar u shpreh: “Ne, tani po e hamë bukën e bardhë, por e kemi faqen e zezë!”

Pse tha kështu ky bir i thjeshtë, por i madh i kombit?

- Ja argumenti më fatkeq:

- në vitet e “diktaturës”, vajzat shqiptare shkolloheshin dhe punonin me nder në vendin e tyre, ishin të lira nga huliganët e të gjitha ngjyrave, ato jetonin krenare dhe kurrë, bile, as nuk ëndrrojnë të martoheshin me fqinjët sllavë: grekë, maqedonë, serbë e të tjerë!...

Kurse, tani në këto vite të “demokracisë” blu, po bëhen skllave, vetëm për një “jetë më të mirë”, për një vend pune etj...

**Pra, po bien pre e njerëzve të huaj,
që se kanë gjakun, as gjuhën tuaj,
e për pak pare, që do të fitoni,
gjakun e të parëve, krejt e harroni! (Pashko Vasa)**

Sot, në kohën e “mrekullive” të “demokracisë” shqiptarët po detyrohen me dhunë o me mashtrime që ta ndërrojnë dhe identitetin e tyre; shovenistët grekë për ta mundësuar qëndrimin e emigrantëve shqiptarë në Greqi, po i detyrojnë t’i ndërrojnë emrat e tyre shqiptarë, duke i kthyer në grekë!

Në kohën e ndritur të Enver Hoxhës, kjo përluje as ka ngjarë dhe as guxonte askush bile, as ta ëndrronte!

-Tani, po bëhet zhurmë e madhe se në vitet e “diktaturës”, shqiptarët nuk ishin të lirë të kalonin kufijtë e të shëtisnin botën!!!

Po tani, kur shqiptarët qenkan të lirë të iken nga sytë këmbët, sa veta ranë deri tani në male në lumenj, liqene e në dete, Fatkeqësisht shifrat janë tmerruese, ato shkojnë jo me dhjetëra, por me qindra...

Nga kjo konstatoj, që nuk është aspak e vërtetë që bota “demokratike” po na ofron aq shumë paqe dhe mikpritje aq sa po çirren sot, “politikanët” në pushtet. Nëse regjimi “diktatorial” i Enver Hoxhës, e paska “izoluar” Shqipërinë, sa i solli kjo humbje në njerëz, mëmëdheut tonë?!

Po, ju or zotërinj “demokratë” që i hapët portat e kalasë “së mbyllur” shqiptare, sa jetëra njerëzish i humbët?!

-Shtroj pyetjen e domosdoshme: kush e paska goditur më shumë Shqipërinë, “mbyllja” apo hapja pa porta?!

Populli ynë e thotë një fjalë të urtë: “gjella me kripë dhe kripa me masë”!

Kështu, do të duhej të qëndronte kjo çështje, e jo gjithçka të zhytej në stih...

-Tani në këtë përvjetorin e 100-të të ditëlindjes së Ever Hoxhës, pas festimit madhështor dhe nderimit krenarisht dhe shqiptarisht atij burri, sërish kanë ngritur kokat “kukuvajkat”, pasardhësit e fashistëve të vjetër e të rinj, ideologët shkretanë të demo(n)kracisë alla berishjane dhe rugovjane, kanë ngritur kokë dhe renegatët ideologët e ‘përjetshëm’ të enverizmit, pikërisht ata/ato, që deri në vitet ‘90-ta kishin folur e shkruar me simpatinë dhe përkushtimin më të madh për PPSH-në dhe Enver Hoxhën!

-Devijatorëve u ranë pendlat, sepse ata e kishin pas me hile; ata nuk kishin folur e shkruar të nxitur nga mendjet dhe zemrat, por nga interesat e tyre personale!

Nga kjo kujtoj këtu atë këngën popullore ironike:

**Çka po i thotë Dema Kadrisë,
s’po ia di rendin burrnisë,
po, ia di dhe ia kam ditë,
disa herë për miq jam fikë...
...sa pata pula e çurana,
pata miq, pata jarana,
po, kur mbeta pa çurana...
m’ikën miq e jarana!**

- Nga kjo del ideja se miqtë e rremë të Enver Hoxhës, ikën kur s’patën më interesa... Aq u bënë betimi i tyre, renegatëve të pacipë!...

Tani, nga shtypi "Shekulli" u njoftuam se: Humbja e dosjeve të UDB-së në Shqipëri, një skandal i rëndë. Puna ka shkuar deri aty sa të zhduken dosjet e UDB-së, nga arkivat shqiptare. Kjo, nuk u bë rastësisht, por edhe naivët e dinë se kjo u bë nga pinjollët e politikës reaksionare serbomadhe për t' i mbuluar gjurmët e krimeve dhe të turpeve të shqiptaro-hiqërve, bashkëpunëtorëve serbofil, të etshëm për ta përmbysur Shqipërinë në bashkëpunim me sojin e rankoviqëve, koçixoxëve, alishukrioviqëve e stojniqëve e të tjerë, të cilët, Enver Shqiptari ua dha dënimin e merituar, ndërsa tani xhuxhmaxhuxhët "analistët " të politikës "shqiptare", si Halil Matoshi, Migjen Kelmendi, Baton Haxhiu, e të tjerë hedhin baltë mbi figurën e ndritur të Enver Hoxhës të nxitur nga qarqet e huaja rekasionare.

I kanë zhdukur ato dosje sepse: ato do t' i ndriçonin më tej arsyet, pse u bënë gjithë ato "krime" mbi bashkëpunëtorët e UDB-së. Dhe, natyrisht se do të demaskoheshin para popullit, "viktimat" e djeshme dhe të sotme... pra, udhëheqësit pakurrizorë dhe sahanlëpirësit e tyre. Kur mungojnë ato dosje me siguri ithtarët e krra-krrasë, do të jenë më të lirë të bëjnë më shumë zhurmë për krimet e "diktaturës" komunsiste. Tani shtroj pyetjen: në këto vite të demokracisë, kur e drejta e mendimi lirë –lejohet si çirreni ju ditë e natë, zogistët paskan të drejtën ta përkujtojnë në Tiranë, në muajin shtator, 2008, atë 80 vjetorin e tyre të "lavdishëm" të mbretërisë "shqiptare" me në krye "lartmadhninë" e tyre Zogollin, kurse enveristët, nuk paskan drejt ta festojnë 100 vjetorin e adhuresit të tyre, Enverin?! Duket qartë qe juve ju mungon arsyeja!

Demokracia e vërtetë, nuk lejon shkarje të tilla alla fashiste!

Në vendet me përvoja të hidhura historike, si Europa, psh, dhe me jetë të gjatë demokratike këto gjëra lejohen dhe kalohen pothuaj pa asnjë mosmarrëveshje ndërnjerëzore dhe brenda kombëtare.

...Dhe, është krejt normale o adoloshentë të "diplomacisë" suaj të mjerë, prandaj mos harroni që: i zoti i shtëpisë duhet domosdoshmërisht, t' i qortojë "fëmijët" që nuk e dëgjojnë! Mjerisht, që tani Shqipëria Natyrale nuk ka zot shtëpie, përndryshe juve do t' jua kishte ngrehur ca veshët!... Prandaj, po e përfundoj këtë shkrim me devizën atdhetare të Bajram Currit:

**"More fëmijë mos folni keq,
i kam mbushur 70 vjet,
s' më ka lidhë krajli as mbreti,
jo po më lidhë Kadri Mehmeti" (kupto Sali Berisha)!**

Enver Hoxhën nuk e kanë mposhtur dot perandoritë fashiste dhe superfuqitë social-imperialiste, si Rusia 200 mijlonëshe e Nikita Hrushqovit, në fillim të viteve '60-ta; ndërsa, ju tani po perpiqeni t' ia ulni vlerat madhështore!!! O mjerim e shkuar mjerimit të pamendimit!

"Lavdi marrëzisë"! Poshtë rrënja e keqe profashiste e tradhtisë!